

Vërejtje: AKP-ja nuk mund të administrojë llojet e pronave në vijim: (i) pronat për të cilat nevojitet miratimi i bashkë-pronarëve dhe kur ai miratim nuk është siguruar; (ii) pronat të cilat sipas raportit të vlerësimit nga AKP-ja nuk përmbushin kriteret për vënien e tyre nën administrimin e AKP-së dhe (iii) pyjet.

Nëse kërkoni mbylljen e rastit, AKP-ja nuk do të ndërmarrë asnjë veprim të mëtutjeshëm në lidhje me kërkesën.

Çdo person mund të paraqesë kërkesë për zbatimin e njërit prej mjeteve ligjore në emrin tuaj, nëse paraqet autorizimin valid nga ju si dhe letërnjoftimin e tij/saj valid.

Anëtar i familjes suaj mund të paraqesë kërkesë për zbatimin e njërit prej mjeteve ligjore në emrin tuaj nëse ai/ajo ofron dëshmi të lidhjes familjare me ju, autorizimin valid nga ju si dhe letërnjoftimin e tij/saj valid. Përjashtimi i vetëm kur anëtar i familjes nuk ka nevojë të paraqesë autorizimin është kur ai/ajo është personi që e ka paraqitur fillimisht kërkesën pronësore ose përgjigjen në emrin tuaj.

Nëse paraqitësi i kërkesës ka vdekur pasi që e ka paraqitur kërkesën, personi i cili kërkon zbatimin e njërit prej mjeteve ligjore në emrin tuaj duhet të prezantojë certifikatën e vdekjes së bashku me certifikatën e martesës (nëse është bashkëshorti/ja), certifikatën e lindjes (nëse është djali/vajza) apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon lidhjen familjare si dhe vendimin valid mbi trashëgiminë të cili e paraqet atë si trashëgimtar të pronës së kërkuar. Pa një vendim valid mbi trashëgiminë, AKP-ja mund të ofrojë vetëm marrjen e pronës nën administrim.

Ju lutem keni parasysh se: Të gjithë personat e regjistruar në AKP si paraqitës të kërkesës, palë përgjegjëse apo palë tjera të interesuara në kërkesë mund të gjejnë informata mbi kërkesën, përfshirë edhe atë nëse është vendosur kërkesa apo jo dhe informata tjera të dobishme, duke e vizituar ueb faqen tonë në www.kpaonline.org.

Ju lutem mos harroni të përditësoni të dhënat tuaja kontaktuese në AKP. Nëse ndërroni adresën, numrin e telefonit apo të dhënat tjera kontaktuese, është me rëndësi që të dhënat tuaja të përditësuara të na i dërgoni me shkrim, së bashku me kopjen e letërnjoftimit tuaj.

Prishtinë

rr. Rexhep Luci 2/ rr. Goleshit 2
Tel: 038 225 473 - fax: 038 244 854
Graçanicë: prapa ndërtesës së komunës
Tel: 038 225 473

Pejë

rr. Mbretëresha Teuta, Nr. 85
Tel: 039 431 668
fax: 039 432 970

Prizren

rr. "William Walker" (në bazën e EULEX-it)
Tel: (038) 760 610/ (038) 760 611

Mitrovicë

Pjesa jugore: rr. Mbretëresha Teuta
(ndërtesa e Jugobankës)
028 530 136 dhe 530 137 - fax: 028 530 139
Pjesa Veriore: rr. Filip Vishnjiq Nr. 4, Dhoma Nr. 18
(ish Ndërtesa e AKM-së), Stacioni Verior i Policisë
Tel: 063 197 6470

Gjilan

rr. Lidhja e Prizrenit Nr. 114
Tel: 0280 320 289 - fax: 0280 324 067

Beograd

rr. Kosovska 49/8
Tel: 011 334 5513 ose 334 5314 Fax: 011 334 4452

Kragujevc

rr. "Llolla Ribar" Nr. 9, Kati 3të
Tel: 034 330-234; 330-784

Nish

rr. "Dusanov Bazar" (Kupola) Kati 3të, Zyrja Nr. 210
Tel: 018 203 777

Podgoricë

rr. Crnogorskih Serdara
Tel: +382 20 624 216/ 20 623 744

Shkup

rr. Vihnička Nr. 10
(ndërtesa CDRIM), kati i 1rë
Tel: +389 226 56 680; +389 226 56 291
Mob: +389 70 544 266

Çfarë ndodh pasi të jetë vendosur kërkesa?



Agjencia Kosovare e Pronës



Çfarë ndodh pasi të jetë vendosur kërkesa?

Kjo fletëpalosje është përpiluar për t'iu ofruar paraqitësve të kërkesës, palëve përgjegjëse dhe palëve tjera të interesuara udhëzime në lidhje me të drejtat e tyre pasi që kërkesa të vendoset nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK).

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ka mandatin të pranojë, regjistrojë dhe, përmes Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), të zgjidhë kërkesat që janë si pasojë e konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 për **pronën e paluajtshme private**, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. KKPK-ja është pjesë e AKP-së dhe përbëhet nga dy komisionerë ndërkombëtarë dhe një vendor. Kundër vendimit të KKPK-së mund të bëhet ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Si do të procesohet kërkesa?

Pas pranimit të kërkesës AKP-ja do të publikojë kërkesën, do të njoftojë për kërkesën uzurpuesin aktual dhe do t'ua mundësojë pjesëmarrjen në procedurë atyre palëve që pretendojnë interes ligjor mbi pronën. Kërkesa do të shqyrtohet individualisht. Kjo përfshinë verifikimin e të gjitha dokumenteve të paraqitura në mbështetje të kërkesës, hulumtimin në të dhënat publike dhe nëse ka nevojë edhe sigurimin e deklaratave dhe dëshmime shtesë. Pasi që kërkesa të jetë shqyrtuar në tërësi, ajo do t'i prezantohet KKPK-së për vendimmarrje.

KKPK-ja do të lëshojë vendim duke aprovuar apo refuzuar kërkesën. Vendimet e KKPK-së janë të detyrueshme pa paragjykim ndaj të drejtës për ankesë.


Ku dhe kur mund ta merrni vendimin?

Nëse jeni paraqitës i kërkesës, ju do të kontaktoheni me telefon nga zyrtarët e AKP-së për të caktuar kohën kur do ta merrni vendimin në njërën nga **zyrat e AKP-së**.

Nëse jeni palë përgjegjëse ose palë tjetër e interesuar e cila ka marrë pjesë në proces, ju do të kontaktoheni me telefon nga zyrtarët e AKP-së për të caktuar kohën kur vendimi do të ju dorëzohet personalisht në adresën tuaj ose nëse dëshironi vendimin mund ta merrni edhe në njërën nga **zyrat e AKP-së**.

Palët e interesuara në kërkesë të cilat nuk kanë marrë pjesë në proces do të kontaktohen nga zyrtarët e AKP-së vetëm atëherë kur AKP-ja të njoftohet personalisht apo zyrtarisht për ekzistencën e palës së interesuar.

Nëse dështoni ta merrni vendimin në kohën e caktuar paraprakisht, ju do të konsideroheni të njoftuar me vendim pas 45 ditësh nga data e dakorduar me ju paraprakisht, duke përfshirë publikimin prej 30 ditësh në Zyrën Regjionale në listën në të cilën evidentohet çdo vendim që nuk është marrë.



A mundet dikush tjetër të marrë vendimin në emrin tuaj?

Çdo person mund të marrë vendimin tuaj nëse paraqet autorizimin valid nga ju si dhe letërnjoftimin e tij/saj valid.

Anëtari i familjes suaj mund të marrë vendimin, por gjithashtu duhet të paraqesë autorizimin valid dhe të ofrojë dëshmi të lidhjes familjare. Përfshirë vetëm kur anëtari i familjes nuk ka nevojë të paraqesë autorizimin është kur ai/ajo është personi që e ka paraqitur fillimisht kërkesën pronësore ose përgjigjen në emrin tuaj.

Nëse paraqitësi i kërkesës ka vdekur pasi që e ka paraqitur kërkesën, personi i cili e merr vendimin duhet të prezantojë çertifikatën e vdekjes së bashku me çertifikatën e martesës (nëse është bashkëshorti/ja), çertifikatën e lindjes (nëse është djali/vajza) apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon lidhjen familjare.

Çka nëse nuk pajtoheni me vendimin?

Nëse nuk pajtoheni me vendimin e KKPK-së ose me ndonjë pjesë të tij, keni të drejtë të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së brenda 30 ditësh nga njoftimi mbi vendimin e KKPK-së. Më shumë informata dhe udhëzime të detajuara mbi procedurën e ankesave janë të shtypura në një faqe të veçantë që i bashkangjitet secilit vendim.

Si të paraqitet ankesa nëse nuk pajtoheni me vendimin?

Nëse mendoni që keni arsye për t'u ankuar ndaj vendimit të KKPK-së, **brenda afatit prej tridhjetë ditësh** duhet të paraqitni ankesën me shkrim, me letër (personalisht ose me postë), me faks apo email (postë elektronike), së bashku me kopjen e Letërnjoftimit tuaj në njërën nga **zyrat e AKP-së**. Më shumë informata dhe udhëzime të detajuara mbi procedurën e ankesave janë të shtypura në një faqe të veçantë që i bashkangjitet secilit vendim.

Çfarë mjetesh ligjore keni në dispozicion nëse jeni paraqitës i suksesshëm i kërkesës?

Paraqitësi i suksesshëm i kërkesës mund të kërkojë **(1) riposëdimin e pronës së kërkuar, (2) mbylljen e rastit apo (3) vënien e pronës nën administrimin e AKP-së**. Formularët për këto kërkesa janë të bashkangjitura në të gjitha vendimet apo aktgjykimet e suksesshme.

Nëse kërkon riposëdimin e pronës së kërkuar, AKP-ja do të ekzekutojë masat që t'ua mundësojë juve riposëdimin e plotë fizik të pronës, siç urdhërohet në vendim apo aktgjykim. Këto mjete ligjore mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm në, dëbimin, vendosjen e pronës nën administrim, marrëveshjen e qirasë, konfiskimin apo prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe shitjen në ankand. Para se të ekzekutohet ndonjëri mjet ligjor, ju do të kontaktoheni nga AKP-ja dhe do të kërkohet nga ju që ta ri-posedoni pronën në datën dhe orën e caktuar sipas marrëveshjes. Do të konsiderohet që ju e keni ri-poseduar pronën edhe nëse nuk paraqiteni aty.

Nëse kërkon administrimin, AKP-ja do të administrojë përkohësisht pronën tuaj në emrin tuaj përderisa ju nuk jeni në gjendje ta riposedoni fizikisht pronën tuaj. Nëse prona është nën administrim të AKP-së, bartësi i së drejtës pronësore mund të kërkojë nga AKP-ja që prona të përfshihet në Skemën e Qirasë të AKP-së: megjithatë pranimi në skemën e qirasë do të varet nga inspektimi i kushteve dhe përshtatshmërisë së pronës. Nëse AKP-ja e vendos pronën në skemën e qirasë, qiraja nga e cila zbritet një shumë e vogël e taksës administrative, do t'i paguhet palës vetëm nëse prona i ipet me qira palës së tretë përmes marrëveshjes mbi qiranë.